



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI

Nr. 2571 Prot
3

Datë 26.3.2020.

URDHËR

Nr. 141, datë 26.3.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURËS SË HOLLËSISHME TË
RREGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 8 të ligjit 17/2020,
“Për produktet plehëruese”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullore së procedurës së hollësishme të rregjistrimit të produkteve plehëruese, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme Rregulatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Bledar Çuçi



RREGULLORE PËR PROCEDURËN E HOLLËSISHME TË RREGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE

KREU I

“DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës të Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese, që nga aplikimi, shqyrtimin, miratimin dhe lëshimin e Çertifikatës së Rregjistrimit dhe etiketës, dhe për çështje të tjera të lidhura me produktet plehëruese.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptimin e kësaj rregulloreje:

- a) “Komisioni” është Komisioni i Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese.
- b) “Laboratori i referencës” është laborator i miratuar me urdhërin e ministrit nr. 354, datë 18.12.2012 “Për miratimin e laboratorit të referencës për analizat e plehrave”.
- c) “Sekretari” është sekretari i komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese, i caktuar me urdhër të ministrit.
- d) “Ligji nr.17/2020 ” është Ligji nr.17/2020 “Për produktet plehëruese”.

Përkufizimet e Ligjit nr.17/2020 kanë të njëjtin kuptim në këtë rregullore.

Neni 3

Baza ligjore

Baza ligjore e procedurës së regjistrimit të produkteve plehëruese janë: Ligji nr.17/2020, Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe aktet nënligjore përkatëse të miratuara në bazë të tyre.

KREU II

APLIKIMI PËR REGJISTRIM DHE PRANIMI

Neni 4

Aplikimi për regjistrim dhe vlerësimi i produkteve plehëruese

1. Aplikimi për regjistrimin e produktit plehërues përmban:
 - a) kërkesën e aplikantit për regjistrimin e produktit plehërues në gjuhën shqipe;
 - b) të dhënat teknike të produktit plehërues në gjuhën shqipe ose angleze;
 - c) etiketën, të përkthyer dhe në gjuhën shqipe;

ç) dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS). MSDS të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat specifike, përmbajtjen e formatin e përcaktuar nga legjislacioni përkatës në fuqi për kimikatet;

d) mostrën e produktit plehërues që kërkon të regjistrojë.

2. Aplikimi për regjistrim, sipas shkronjave “a” deri “ç”, të pikës 1, të këtij neni, kryhet në sistemin *online*, ndërsa mostra, sipas shkronjës “d”, të këtij neni, depozitohet nga aplikanti te laboratori i referencës. Deri në bërjen e aksesueshme të sistemit *online*, dokumentat sipas shkronjave “a” deri “ç” do të paraqiten në emailin zyrtar të sekretarit.

Neni 5 Pranimi dhe dërgimi për vlerësim

1. Sekretari, pasi verifikon dokumentat sipas shkronjave “a” deri “ç”, të pikës 1, të nenit 4, i pranon nëse janë në rregull. Nëse nuk janë në rregull, njofton menjëherë me email aplikantin për mangësitë e konstatuara, i cili duhet ti plotësojë dhe dërgojë brenda 2 ditëve nga njoftimi.

2. Pas pranimit, ky dokumentacion dërgohet me email zyrtar nga sekretari te laboratori i referencës, për të kryer vlerësimin e të dhënave të produktit plehërues..

Neni 6 Vlerësimi

2. Laboratori i referencës e pasqyron vlerësimin në sistemin *online* brenda 5 ditëve nga dërgimi me email sipas pikës 1, të këtij neni. Deri në bërjen e aksesueshme të sistemit *online*, vlerësimi do dërgohet te sekretari me email zyrtar.

Neni 7 Njoftimi për mbledhjen e komisionit

1. Sekretari përgatit materialin përmbledhës për mbledhjen e radhës së KRPMB-së brenda 3 ditëve, nga ardhja e mendimeve të laboratorit të referencës dhe njofton me email kryetarin e komisionit për datën e mbledhjes.

2. Procedura e regjistrimit të produktit plehërues përfundon brenda 20 ditëve nga aplikimi.